



<b>REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO</b> <b>AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT</b> <b>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE</b> <b>ANTI-CORRUPTION AGENCY</b>	
Dep.	
Dep.	<u>2-D/DPK</u>
Dep.	
Nr. I tag.	
Broj stranica	<u>02</u>
Nr. pages	
Nr. Prot.	<u>01-312/14</u>
Br. Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	
Date	<u>28.01.2014</u>
PRISHTINE	



## **Republika e Kosovës** **Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.01.2014, mori:

### **V E N D I M**

**I. Mbylljet rasti me nr. AKK-03-4238/13, për z. Sami Duraku – Kryesues i Departamentit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### **A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Sami Duraku – Kryesues i Departamentit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.Sh. “Gis”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Duraku është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit. Pas pranimit të kësaj shkresë, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet ti bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Duraku, është pajtuar me situatën në të cilën ndodhet dhe ka deklaruar se nuk ka qenë i informuar, e as nuk ka pasur njohuri për këtë situatë që mund të sjellë në gjendje të konfliktit të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohe z. Duraku, ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03- 212/14) në të cilën vërtetohet se është bërë asgjësimi, shuarja vullnetare e biznesit privat N.Sh “Gis”.

Me këtë ai ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (parografi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencise kundër Korruptionit

